



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Kompania Regionale "Pastrimi" Sh.A



Kompania Rajonale e Mbeturinave Regjionale kompanija za Uklanjanje Otpada "PASTRIMI" SH.A / d.d.	
Nr. 02/01/22	Shtojcë
Dt. 11-02-2025	1
Prishtinë-Prishtina	

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA DIREKTORIA E ADMINISTRATIVËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dostavljeno më 11.02.2025		
Nr. org.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
Org. kod.		
02-016/01-0009688/25		
PODUJEVË - PODUJEVO		

E lidhur me datë 24.01.2025 ndërmjet palëve si vijon:

1. **KOMUNA E PODUJEVËS** më tej '**Komuna**', me adresë në Rrugën "Nuhi Gashi" në Podujevë, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës së Podujevës, z. Shpejtim Bulliqi, dhe
2. **KOMPANIA RAJONALE PËR MBETURINA "PASTRIMI" SH.A**, më tej '**Kompania**' me adresë në rrugën "Tahir Zajmi" Nr.5 në Prishtinë, përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv, z. Petrit Reçica.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi në mes Komunës së Podujevës dhe Kompanisë Rajonale "Pastrimi" SH.A, është ofrimi i ndihmës për participim në pagesën e 12 (dymbëdhjetë) punëtorëve fizik sezonal të Kompanisë për periudhën 1 vjeçare (nga data 1 Shkurt 2025 deri më 31 janar 2026) për kryerjen e punëve në menaxhimin e mbeturinave, si në vijim:
 - 1.1. Largimin e deponive ilegale;
 - 1.2. Largimin e mbeturinave voluminoze;
 - 1.3. Pastrimin e sipërfaqeve publike;
 - 1.4. Punët tjera, varësisht nga nevoja në terren, për të ndihmuar Njësinë e Kompanisë në Podujevë në grumbullimin e mbeturinave.
2. Përzgjedhja e punëtorëve bëhet sipas rekomandimit të listës nga Agjencioni i Punësimit të Republikës së Kosovës në Podujevë dhe në bashkëpunim me Komunën e Podujevës.

Neni 2

Vlera e Financimit

1. Vlera e përgjithshme për pagesën e punëtorëve sezonal, sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje është në shumë prej 57 600.00 € (pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind euro).
2. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Komuna e Podujevës do të participoj me mjete financiare në shumë prej 28 800.00 € (njëzetë e tetë mijë e tetëqind euro).
3. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, do të participoj me mjete financiare në shumë prej 28 800.00 € (njëzetë e tetë mijë e tetëqind euro).
4. Paga mujore për 12 punëtorët sezonal sipas kësaj marrëveshje caktohet në shumë prej 400 € në muaj për secilin punëtor për periudhën 1 vjeçare.

Neni 3

Obligimet e Komunës

1. Komuna e Podujevës obligohet që për pagesën e punëtorëve sezonal, sipas kësaj marrëveshje të siguroj mjete financiare në shumë prej 28 800.00 € nga buxheti i Komunës.
2. Të caktoj një përfaqësues nga Komuna e Podujevës në cilësinë e mbikëqyrësit të realizimit të punëve në terren sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Komuna e Podujevës mjetet financiare në shumë prej 28 800.00 €, do t'i transferoj në llogarin bankare të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A me nr. 1700200100051292 në NLB-Bank.

Neni 4

Obligimet e Kompanisë

1. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, obligohet që për pagesën e 12 punëtorëve fizik sezonal të siguroj mjete financiare në shumë prej 28 800.00 € për ngritjen e kualitetit të grumbullimit të mbeturinave për interesin e përgjithshëm të qytetarëve.
2. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A – Njësia në Podujevë, në bashkëpunim me Komunën e Podujevës monitoron mbarëvajtjen e menaxhimit të mbeturinave dhe punëve tjera mjedisore në funksion të pastrimit të hapësirave publike në terren.
3. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, duhet t'i dorëzoj raport me shkrim Komunës së Podujevës për realizimin e punëve në terren si dhe për shpenzimin e mjeteve të destinuara sipas kësaj Marrëveshjeje.
4. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, obligohet për përpilimin e kontratave të punës për punëtorët e kontraktuar sezonal sipas nenit 1 par 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe kërkimin e të dhënave sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Zbatimi

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme dhe e vlefshme deri në përmbushjen e obligimeve nga të dyja palët.

Neni 6

Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet e krijuara nga Marrëveshja e Bashkëpunimit duhet të zgjidhen përmes bisedimeve midis palëve. Nëse dështojnë bisedimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 7

Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e bashkëpunimit është përpiluar në 4 (katër) kopje identike dhe të mjaftueshme për palët.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.



Datë 24.01.2025

Kryetari i Komunës së Podujevës

